



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Raporti i Vlerësimit Ex-Post

për

Udhëzimin Administrativ (QRK) - Nr. 10/2017 për Listën e Treguesve për

Identifikimin Zyrtar të Viktimave të Trafikimit me Njerëz

Prishtinë, Dhjetor 2023

Institucioni propozues	Ministria e Drejtësisë, Departamenti Ligjor
Titulli i Raportit të Vlerësimit Ex-Post	Raport i Vlerësimit Ex-Post i Udhëzimit Administrativ QRK-Nr. 10/2017 për Listën e Treguesve për Identifikimin Zyrtar të Viktimave të Trafikimit me Njerëz
Personi kontaktues	Feride Podvorica, zv. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë
Grupi punues	<ol style="list-style-type: none"> 1.1. Feride Podvorica, Departamenti Ligjor/MD, Koordinatore; 1.2. Nazlie Bala, Këshilltare, Kabineti i Ministres së Drejtësisë, Anëtare; 1.3. Alberta Hyseni, Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit, Anëtare; 1.4. Sebahate Sinani, Prokurore, Anëtare; 1.5. Riza Murati, Policia e Kosovës, Anëtar; 1.6. Zana Selimi, Departamenti Ligjor/MD, Anëtar; 1.7. Filloreta Gashi, Ministria e Shëndetësisë, Anëtare; 1.8. Azize Sekiraqa, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Anëtare; 1.9. Demë Hasanaj, Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave, Anëtar; 1.10. Abaz Gjikolli, Qendra për Mirëqenie Sociale/Fushë Kosovë, Anëtar; 1.11. Eliza Shporta, Ambasada Amerikane në Prishtinë, përfaqësuese.
Data	13.12.2023

1. Raporti i Vlerësimit Ex-Post për Udhëzimin Administrativ (QRK) - Nr. 10/2017 për Listën e Treguesve për Identifikimin Zyrtar të Viktimave të Trafikimit me Njerëz , i miratuar me Vendimi e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.24/180 dt.27.12.2023

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Trafikimi i qenieve njerëzore është shkelje e drejtpërdrejtë e të drejtave të njeriut. Qëllimi i trafikimit është kontrollimi dhe shfrytëzimi i viktimave të cënueshme, përmes përdorimit të kërcënimit, forcës, mashtrimit ose rrëmbimit. Nga trafikimi me qenie njerëzore, trafikantët kryesisht përfitojnë nga shfrytëzimi seksual dhe në punë i viktimave të trafikimit, që janë më së shpeshti individë me arsimim dhe/ose mjete financiare të kufizuara. Në këtë drejtim, eliminimi i trafikimit me qenie njerëzore është në mënyrë të pashmangshme një proces i rëndësishëm, por afatgjatë, i cili kërkon eliminimin e shkaqeve rrënjësore të problemit (të tilla si pabarazia gjinore, varfëria, të drejtat e pakicave, arsimit dhe kujdesi shëndetësor) dhe ç'aktivizimin e rrjeteve kriminale.
2. Një nga aktivitetet më të rëndësishme në procesin e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore është identifikimi i viktimave. Në këtë drejtim, identifikimi zyrtar në Republikën e Kosovës është përcaktuar me nenin 12 (1) të Ligjit Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, me të cilin përcaktohet se identifikimi zyrtar i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore bëhet nga njësitë përkatëse të Policisë, Prokurorisë, Mbrojtësve të Viktimave dhe Qendrave për Punë Sociale. Gjithsesi, me qëllim që procedura e identifikimit të kryhet me sukses, është vlerësuar e nevojshme që të përcaktohen dhe të harmonizohen treguesit për identifikim, të cilët ndryshojnë në varësi të situatës në të cilën ndodhet viktimja. Lista e treguesve në fjalë është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 10/2017 për Listën e Treguesve për Identifikimin Zyrtar të Viktimave të Trafikimit me Njerëz (në tekstin e mëtejme “Udhëzimi Administrativ”), i cili është objekt i këtij vlerësimi *ex-post*.
3. Për shkak të rëndësisë së identifikimit të suksesshëm dhe efektiv të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Kosovës, Ministria e Drejtësisë ka themeluar grupin punues për vlerësimin *ex-post* të Udhëzimit Administrativ.
4. Qëllimi i këtij vlerësimi *ex-post* është të identifikojë mangësitë dhe të propozojë rekomandimet përkatëse për zbatimin e duhur të Listës së Treguesve, dhe përfshirjen e grupeve të reja treguesish që lidhen me dinamikën e reja në fushën e luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore. Për më tepër, raporti synon të shërbejë si bazë për përmirësimin e mëtejme të parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Kosovës, si një nga segmentet më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

5. Për të arritur qëllimin e lartcekur, në përputhje me udhëzimet e vlerësimit *ex-post* të përcaktuara në Manualin për Vlerësimin *Ex-Post* të Akteve Juridike,¹ grupi punues është përcaktuar në metodën e “**Vlerësimit të zbatimit dhe përputhshmërisë**” si një nga tre llojet e vlerësimit *ex-post*. Kjo, me qëllim të vlerësimit të zbatimit të Listës së Treguesve të përcaktuar me Udhëzim Administrativ. Në shtesë të vlerësimit të zbatimit, grupi punues ka vlerësuar edhe nivelin e harmonizimit të Udhëzimit Administrativ me legjislacionin tjetër në fuqi në fushën e identifikimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.
6. Në përmbledhje, raporti thekson rëndësinë e përfshirjes së treguesve të rinj që do të fokusohen në tendencat e reja të trafikimit me qenie njerëzore, si rekrutimi dhe shfrytëzimi në internet i viktimave të trafikimit, si dhe trafikimi i qenieve njerëzore në mesin e emigrantëve të parregullt dhe azilkërkuesve. Gjithashtu, meqenëse disa raporte ndërkombëtare tregojnë se në Republikën e Kosovës, ekziston rreziku real i një pranie të shtuar të trafikimit të fëmijëve, veçanërisht për qëllime të kërkim lëmshës së detyruar, raporti rekomandon forcimin e treguesve që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e fëmijëve për martesë të detyruar dhe/apo për kërkim lëmshë të detyruar. Në përmbyllje të tij, raporti ofron rekomandime për veprimet korrigjuese në lidhje me Listën e Treguesve. Më konkretisht, ky raport rekomandon se si të harmonizohet Lista përkatëse e Treguesve me listat e tjera të treguesve që kanë të bëjnë me identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, dhe se si të udhëzohen institucionet përkatëse në zbatimin e tyre.

I. HYRJE

I.1. Konteksti i vlerësimit

7. Një mori e raporteve ndërkombëtare ka theksuar nevojën e ndërmarrjes së hapave të nevojshëm për identifikimin e viktimave të trafikimit me njerëz. Konkretisht, GRETA (Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore nga palët) në raportin e dytë vlerësues për Republikën e Kosovës (2021), ka kërkuar nga autoritetet shtetërore që të ndërmarrin hapa të mëtejshëm për të siguruar identifikimin në kohë të viktimave të trafikimit. Kjo, duke përfshirë promovimin e përfshirjes së shumë agjencive në identifikimin e viktimave dhe duke siguruar që të gjithë profesionistët që mund të vijnë në kontakt me viktimat të marrin trajnim sistematik dhe të vazhdueshëm. Tutje, GRETA ka shprehur mendimin se autoritetet e Kosovës duhet gjithashtu të bëjnë përpjekje për të rritur kapacitetin e punonjësve social, për të identifikuar në mënyrë proaktive viktimat e trafikimit dhe për të forcuar masat për identifikimin e viktimave, në mesin e

¹ Manuali për Vlerësimin *Ex-Post* të Akteve Juridike është miratuar në Mbledhjen 145-të të Qeverisë, me Vendimin Nr. 07/145, të dates 07.06.2023.

emigrantëve të parregullt dhe azilkërkuesve. Gjithashtu, GRETA u ka kërkuar autoriteteve të Kosovës të përforcojnë identifikimin proaktiv të fëmijëve viktime të trafikimit, të rishikojnë aplikimin e sistemit të kujdestarisë, t'u kushtojnë vëmendje më të madhe fëmijëve që trafikohen nga prindërit ose anëtarët e tyre të familjes dhe të prezantojnë një procedurë për identifikimin e viktimeve të qenieve njerëzore mes fëmijëve të huaj të pa shoqëruar.

8. Në shtesë të GRETA-s, TIP (Raporti Vjetor i Trafikimit me Qenie Njerëzore i nxjerrë nga Departamenti i Shtetit Amerikan), ka kërkuar nga institucionet e Republikës së Kosovës që të ndërmarrin përpjekje të mëtejme për të identifikuar në mënyrë efektive fëmijët që shfrytëzohen për qëllime të kërkim lëmshës së detyruar.
9. Duke u nisur nga këto të gjetura të cilat evidentojnë rrezikun real të shtimit të numrit të fëmijëve të trafikuar, veçanërisht për qëllime të kërkim lëmshës së detyruar, Ministria e Drejtësisë ka inicuar vlerësimin *Ex-Post* të Udhëzimit Administrativ. Në vijim të kësaj, është themeluar grupi punues i kryesuar nga Ministria e Drejtësisë dhe me përbërje të përfaqësuesve të institucioneve kyçe në fushën e parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore, si, Zyra e Kryeministrit, Policia e Kosovës, Prokuroria, Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Zyra për Mbrojtjen e Viktimeve, Qendra për Punë Sociale, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Shëndetësisë.

I.2. Qëllimi dhe fushëveprimi i vlerësimit

10. Qëllimi i këtij raporti të vlerësimit *ex-post* është të evidentojë sfidat kryesore në fushën e identifikimit të viktimeve të trafikimit me qenie njerëzore dhe sfidat e institucioneve përgjegjëse për identifikimin zyrtar të viktimeve në zbatim të Listës së Treguesve të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ. Raporti gjithashtu synon, të vlerësojë nivelin e bashkëpunimit të ndërsjellë të organeve relevante, duke përfshirë vendosjen e bashkëpunimit me organe të tjera që mund të marrin pjesë gjithashtu në identifikimin e viktimeve.
11. Tutje, Raporti propozon rekomandimet përkatëse për zbatimin e duhur të Listës së Treguesve, dhe përfshirjen e grupeve të reja të treguesve që lidhen me tendencat e reja në fushën e luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore, duke përfshirë propozime konkrete se si të harmonizohet Lista përkatëse e treguesve me tregues të tjerë që janë aktualisht në fuqi. Përveç kësaj, raporti synon të shërbejë si bazë për përmirësimin e ardhshëm të sistemit të ndalimit të trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Kosovës, si një nga segmentet më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

12. Në këtë drejtim, vlerësimi *ex-post* i Udhëzimit Administrativ konsiderohet si mjet thelbësor në identifikimin e nivelit të zbatimit, sfidave të hasura gjatë zbatimit të tij, si dhe masat që duhen marrë për të përmirësuar zbatimin e Listës. Njëherit, ky raport është dokumenti i parë zyrtar dhe konkret që në mënyrë koncize nxjerr në pah problemet në zbatimin e kësaj Liste të Treguesve. Si i tillë, ky vlerësim përbën një hap të rëndësishëm në zhvillimin dhe harmonizimin e sistemit për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Kosovës.
13. Për sa i përket fushëveprimit të këtij vlerësimi *ex-post*, grupi punues ka vlerësuar tërë listën e treguesve, pra, Udhëzimin Administrativ në tërësi, nga hyrja e tij në fuqi deri më tani. Konkretisht, është vlerësuar aspekti i harmonizimit të Listës së Treguesve, me zhvillimet më të fundit në fushën e luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore. Është shqyrtuar heqja e treguesve të panevojshëm, kryerja e trajnimeve për organet përgjegjëse për zbatimin e Listës së Treguesve dhe përmirësimi i koordinimit të aktiviteteve ndërmjet organeve zbatuese.

II. PËRSHKRIMI I AKTIT NËNLIGJOR DHE METODOLOGJIA E ZBATUAR

II.1. Përshkrimi i aktit nënligjor që do të vlerësohet

14. Siç u theksua tashmë në pjesën hyrëse, identifikimi zyrtar në Republikën e Kosovës është përcaktuar me nenin 12 (1) të Ligjit Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, me të cilin përcaktohet se identifikimi zyrtar i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore bëhet nga njësitë përkatëse të Policisë, Prokurorisë, Mbrojtësve të Viktimave dhe Qendrave për Punë Sociale, kur ka dyshime të bazuara se një person i caktuar është viktimë e trafikimit, në përputhje me Procedurat Standarde të Operimit, të zhvilluara nga autoritetet përkatëse.
15. Gjithashtu, në nenin 12, paragrafin 2 të Ligjit Nr. 04/L-218, përcaktohet se Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, harton listën e treguesve lidhur me trafikimin me qenie njerëzore, me qëllim të lehtësimit të identifikimit të viktimave nga autoritetet policore e gjyqësore, që mund të jenë në kontakt me viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit.
16. Tutje, në nenin 12 (3) të Ligjit Nr. 04/L-218, përcaktohet se me propozimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerrin udhëzime specifike për shërbimet konsullore, kufitare, policinë dhe inspektorët e punës me qëllim të identifikimit të hershëm të viktimave të trafikimit.

17. Në rrjedhë të kësaj, është nxjerrë Udhëzimi Administrativ QRK -Nr. 10/2017 për Listën e Treguesve për Identifikimin Zyrtar të Viktimave të Trafikimit me Njerëz, i cili është objekt i këtij vlerësimi *ex-post*. Ky Udhëzim Administrativ përcakton listën e treguesve të mundshëm për lehtësimin e identifikimit të viktimave nga autoritetet policore e gjyqësore që mund të jenë në kontakt me viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit me qenie njerëzore.

18. Meqenëse nuk ka të dhëna nëse është bërë një vlerësim i ndikimit rregullativ para nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ, qëllimet e kësaj liste treguesish mund të përcaktohen duke e analizuar vetë Listën.

19. Në këtë drejtim, qëllimi kryesor i Listës së Treguesve në lidhje me elementet kryesore të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore (veprimet, mjetet dhe qëllimi) është të mundësojë dhe përmirësojë identifikimin zyrtar të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore nga autoritetet përkatëse.

20. Treguesit e identifikimit në listën në fjalë janë kategorizuar në bazë të elementeve të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore, siç janë përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-218 dhe Kodin Penal. Treguesit në fjalë përmbajnë elementet e mëposhtme:

- **Veprimet:** rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave;
- **Mjetet:** kërcënimi, përdorimi i forcës, forma të tjera shtrëngimi, rrëmbimi, mashtrimi, mosveprimi, shpërdorimi i pushtetit ose pozicioni i cenueshmërisë, dhënia ose marrja e pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një tjetër person;
- **Qëllimi i shfrytëzimit:** përfshin, por nuk kufizohet në, prostitucionin, pornografinë ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, lypjen lëmshën, punën ose shërbimet e detyruara ose të detyrueshme, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve;

21. Treguesit e **veprimeve** janë përcaktuar me nenet 5-7, si në vijim:

21.1 Meqë faza fillestare dhe veprimi fillestar i procesit të trafikimit të qenieve njerëzore është rekrutimi i viktimave, neni 5 i Udhëzimit Administrativ përcakton treguesit e rekrutimit, i cili kryhet në dy mënyra, me mashtrim të plotë dhe të pjesshëm.

21.2 Tutje, neni 6 i Udhëzimit përcakton fazën e dytë të trafikimit me qenie njerëzore, i cili është transportimi i viktimës në destinacion. Sipas nenit në fjalë, transporti përtej kufirit mund të jetë i ligjshëm ose i paligjshëm dhe viktimat mund të kalojnë nëpër disa vende. Gjithashtu, disa viktimat udhetojnë pa pasaportë sepse u është thënë se nuk ka nevojë reale për një të tillë ose se do t'a marrin më vonë, ose nëse ata kanë një pasaportë, ajo shpesh merret nga trafikanti. Kjo e fundit tashmë e vendos viktimën në një marrëdhënie varësie me trafikantët.

21.3 Neni 7 përcakton treguesit e pranimit dhe strehimit. Në këtë fazë merren dokumentet personale të viktimës dhe vendoset kontrolli mbi viktimën. Kushtet e strehimit të viktimave janë tregues kryesor që një person mund të jetë i trafikuar. Trafikantët iu ofrojnë mundësi strehimi viktimave por jo edhe kushte të mira në vendin ku banojnë ato. Nëse personat jetojnë dhe flejnë në ambientet ku punojnë dhe kanë kushte e banimit janë adekuate, këto janë tregues shumë të fuqishëm të trafikimit me njerëz.

22. Treguesit e **mjeteve** të trafikimit përcaktohen me nenet 9-14, si në vijim:

22.1 Neni 8 i Udhëzimit liston treguesit e kërcënimit. Qëllimi kryesor i kërcënimit është të shkaktojë frikë, ankth, pasiguri dhe rrezikim personal te viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe në rrethana të tilla, viktimat do të ishte edhe më e ndjeshme ndaj shfrytëzimit.

22.2 Neni 9 përmban treguesit e përdorimit të forcës. Në këtë fazë, treguesit bëhen më të lehtë për t'u njohur, pasi ka edhe shenja të jashtme lëndimesh tek viktimat, si djegie, lëndime në kokë dhe tronditje, mavijosje, prerje dhe gërvishtje, dhe kocka të thyera.

22.3 Neni 10 përmban treguesit e formave të shtrëngimit, kufizimit të lëvizjes, izolimit, mbajtjes së dokumenteve ose rrëmbimit. Shtrëngimi konsiston në aplikimin e forcës ose kërcënimeve të drejtuara ndaj viktimës së trafikimit me qenie njerëzore, në mënyrë që viktimat të bëhet objekt shfrytëzimi, ndërsa kufizimi i lëvizjes dhe izolimi kryhet duke vendosur barriera të ndryshme fizike dhe duke kontrolluar hapësirat ku ndodhet viktimat.

22.4 Tutje, neni 11 përcakton treguesit e mashtrimit. Ky i fundit karakterizohet nga përfaqësimi i rremë ose fshehja e fakteve me qëllim të mashtrimit të viktimës, në mënyrë që viktimat, pasi mashtrohet, të mund të shfrytëzohet.

22.5 Në vijim, neni 12 i Udhëzimit Administrativ përcakton treguesit e abuzimit me pushtetin, autoritetin ose pozicionin e cënueshmërisë. Keqpërdorimi i pushtetit, autoritetit apo pozitës më së shpeshti karakterizohet nga shfrytëzimi i viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore nga personi që duhej t'a mbronte, më së shpeshti nga anëtarët e familjes.

22.6 Tutje, neni 13 përcakton treguesin e mbajtjes së pagave si një nga mjetet e trafikimit. Kjo fazë është shumë afër fazës së shfrytëzimit sepse viktimës nuk i jepet kompensim adekuat (ose aspak) për punën e tij/saj, që padyshim paraqet shfrytëzim.

22.7 Si mjet i fundit i përcaktuar në nenin 14 të Udhëzimit është dhënia ose marrja e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër.

23. Treguesit e **qëllimit** të trafikimit janë rregulluar me nenet 15-19 të Udhëzimit Administrativ, me përmbajtjen, si në vijim:

23.1 Neni 15 përcakton treguesit e qëllimit të shfrytëzimit seksual, e cila njëherit është forma më e zakonshme e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

23.2 Neni 16 përmban treguesit e trafikimit për shfrytëzim për punë të detyruar, si formë në rritje, madje mbizotëruese e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit në disa vende.

23.3 Treguesit e trafikimit me qëllim të shfrytëzimit për lëmoshë përcaktohen në nenin 17.

23.4 Neni 18 i Udhëzimit Administrativ përcakton treguesit e trafikimit me qëllim të shfrytëzimit për skllavëri shtëpiake.

23.5 Për fund, neni 19 përmban treguesit e trafikimit me qëllim të heqjes së organeve.

24. Për fund, treguesit që lidhen me elementë të veçantë janë:

- Treguesit e trafikimit për identifikimin e fëmijëve të shfrytëzuar dhe;
- Treguesit e fëmijëve nën rrezik të mundshëm trafikimi.

25. Treguesit e veçantë nga paragrafi 24 përcaktohen me nenet 21 dhe 22 të Udhëzimit Administrativ. Në këtë drejtim, neni 21 përcakton treguesit për identifikimin e fëmijës së trafikuar, ndërsa neni 22 përcakton treguesit e fëmijëve nën rrezik të mundshëm trafikimi.

II.3. Metodologjia

26. Ky raport i vlerësimit *ex-post* është hartuar nga grupi punues i kryesuar nga Ministria e Drejtësisë dhe me përbërje të përfaqësuesve të institucioneve të tjera kompetente në fushën e parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore. Grupi punues është mbështetur me ekspertizë në fushën ligjore dhe në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore, nga Projekti EUKOJUST, i financuar nga Bashkimi Evropian.

27. Gjatë hartimit të raportit, grupi punues është fokusuar në përdorimin e metodës së analizës, e cila bazohet në vlerësimin e suksesit në zbatimin e treguesve përkatës, dhe përputhshmërinë e tyre me dinamikat aktuale të fushës. Përmes kësaj metodologjie, grupi punues ka evidentuar sfidat kryesore në lidhje me domosdoshmërinë e harmonizimit të ndërsjellë të akteve që përcaktojnë treguesit për identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

28. Me qëllim të hartimit të raportit, grupi punues ka analizuar të dhëna të nxjerra nga dy burime:

- (i) **Burimet primare:** legjislacioni në fuqi në fushën e identifikimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore;
- (ii) **Burimet dytësore:** raporte dhe dokumente të tjera nga institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që merren me luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore,

veçanërisht identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore si dhe takime me këto institucione për të mbledhur të dhënat e nevojshme.

29. Në kuadër të burimeve dytësore janë mbledhur të dhëna dhe informacione nga takimet e zhvilluara me përfaqësues nga institucionet përkatëse si: Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Njerëz, Policia e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Qendrat për Punë Sociale dhe Zyra për Mbrojtjen e Viktimave.
30. Përveç kësaj, janë konsultuar raportet e organizatave përkatëse ndërkombëtare, mbi efektivitetin e identifikimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Kjo me qëllim të vlerësimit të suksesit të zbatimit të treguesve për identifikimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.
31. Tutje, me qëllim të gjetjes së informacionit të nevojshëm, është përgatitur një pyetësor, i cili fillimisht u është dërguar akterëve kryesorë në fushën e zbatimit të listës së treguesve të trafikimit, dhe pastaj është diskutuar gjatë takimeve të lartë përmendura. Pyetësi përmban pyetje nga fusha e efektivitetit, rëndësisë dhe mospërputhjes së treguesve të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ.
32. Siç u theksua, pyetësi i është dërguar institucioneve të lartpërmendura, mirëpo grupi punues ka pranuar përgjigje vetëm nga disa prej tyre. Kjo e fundit e ka minimizuar kontributin e pyetësit në përgatitjen e raportit. Pra, me një numër kaq të vogël të pyetësorëve të plotësuar, është shumë e vështirë të vlerësohet niveli i saktë i njohurive të zbatuesve për përmbajtjen e Listës së Treguesve.
33. Në shtesë të këtij pyetësi, është me rëndësi të theksohet se edhe Ambasada Amerikane në Kosovë ka hartuar një pyetësor të ngjashëm me qëllim të vlerësimit të zbatimit të listës së treguesve. Nga të dhënat zyrtare, figuron se gjithsej 30 të anketuar kanë plotësuar pyetësin. Nga ky numër, 26 ishin nga institucionet zbatuese (10 nga njësitë policore, 5 nga prokuroria, 7 nga mbrojtësit e viktimave dhe 4 nga Qendra për Punë Sociale). Gjithashtu, të dhënat dëshmojnë se 73,33% e të anketuarve kanë deklaruar se e njohin plotësisht listën e treguesve, ndërsa 44,83% e të anketuarve kanë pasur rastin të aplikojnë Listën e Treguesve në praktikë. Kjo e fundit tregon që 55,17% e të anketuarve nuk e kanë ndjekur praktikën e Listës së Treguesve.
34. Për fund, vlen të theksohet se gjatë hartimit të këtij raporti të vlerësimit *ex-post*, grupi punues ka hasur në sfida lidhur me mungesën e të dhënave të nevojshme statistikore për viktimat e identifikuar sipas elementeve mbi të cilat bazohen treguesit.

III. REZULTATET E VLERËSIMIT

Rëndësia

35. Lista e treguesve për sistemin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, e përcaktuar në Udhëzim Administrativ është tejet e rëndësishme, në veçanti duke pasur parasysh arsyen, si në vijim:

35.1 Identifikimi i viktimës është proces që përmban një sërë ndërveprimesh, përmes të cilave një individ identifikohet si viktimë trafikimi nga palët përkatëse të interesit. Identifikimi mund të jetë proaktiv kur institucionet përkatëse (praktikuesit) identifikojnë viktimat e trafikimit gjatë punës së tyre. Identifikimi është rrallëherë reagues kur një individ vetë identifikohet si viktimë trafikimi dhe kërkon ndihmë. Proceset e identifikimit të fëmijëve kërkojnë kontaktimin dhe përfshirjen e autoriteteve përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve (punonjësit social) dhe zbatimin e një sërë masash mbrojtëse dhe qasjesh specifike. Identifikimi zyrtar është përcaktimi zyrtar që një person është viktimë e trafikimit, që shpie në referim vullnetar për ndihmë, mbrojtje, riintegrim dhe ndihmë ligjore.

Harmonizimi

36. Gjatë vlerësimit është evidentuar se është në fuqi edhe një listë tjetër e treguesve e përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2014 për identifikimin e hershëm të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore nga Shërbimet Konsullore, Policia Kufitare dhe Inspektorati i Punës. Pra, të gjitha organet që janë zbatues të indikatorëve të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ QRK- Nr. 10/2017, janë përgjegjës për të njëjtën veprimtari edhe në kuadër të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2014. Prandaj, përfshirja e detyrave dhe përgjegjësive të zbatuesve të tyre në një dokument të vetëm, mund të sigurojë bashkëpunim dhe koordinim efikas të ndërsjellë të të gjitha agjencive në Republikën e Kosovës, përgjegjëse për identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

37. Gjithashtu, vlen të theksohet se përveç Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ të përmendur më lartë, ekzistojnë edhe disa akte dhe dokumente përkatëse që rregullojnë identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Kosovës, si:

37.1 Procedurat standarde të veprimit për personat e trafikuar në Kosovë;

37.2 Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë 2022-2026;

37.3 Plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë 2022-2024;

37.4 Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2014 për identifikimin e hershëm të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore nga Shërbimet Konsullore, Policia Kufitare dhe Inspektorati i Punës;

37.5 Treguesit Shëndetësor dhe Udhëzuesi për profesionistët e shëndetësisë për të përmirësuar identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit në Ballkanin Perëndimor.

Zbatueshmëria

38. Nga statistikat zyrtare për numrin e viktimave të identifikuara të trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Kosovës përgjatë periudhës 2015-2022, rezulton se që nga viti 2017, kur është miratuar Udhëzimi Administrativ, numri i viktimave të identifikuara të trafikimit me qenie njerëzore nuk është rritur, por është vërejtur një rënie gjatë disa viteve, krahasuar me numrin e viktimave të identifikuara para miratimit të treguesve përkatës.

39. Sipas viteve, janë identifikuar gjithësej:

- 30 viktima në vitin 2015;
- 36 viktima në vitin 2016;
- 32 viktima në vitin 2017;
- 15 viktima në vitin 2018;
- 26 viktima në vitin 2019;
- 17 viktima në vitin 2020;
- 22 viktima në vitin 2021 dhe
- 21 viktima në vitin 2022.

40. Nga të dhënat statistikore figuron se shumica dërrmuese e viktimave të identifikuara (135) në Republikën e Kosovës që nga viti 2015 janë femra, kryesisht viktima të shfrytëzimit seksual, i cili bëhet në shtëpi private dhe lokale nate. Për shkak të peshës së konsiderueshme të shfrytëzimit seksual në numrin total të rasteve të trafikimit me qenie njerëzore, është e rëndësishme që treguesit e përcaktuar në nenin 15 të jenë të përcaktuar qartë.

41. Tutje, në lidhje me treguesit e trafikimit për shfrytëzim për punë të detyruar sipas nenit 16, sipas të dhënave, figuron se burrat përbëjnë shumicën e viktimave të identifikuara të trafikimit për motive punësimi në sektorë të ndryshëm si bujqësia, ndërtimi, mikëpritja dhe peshkimi. Në anën tjetër, gratë janë viktima të trafikimit për shfrytëzim pune, shpesh në një mjedis më të izoluar të punës shtëpiake dhe të kujdesit. Në Republikën e Kosovës që nga viti 2015 janë identifikuar 31 viktima të

trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të punës së detyruar. Duke qenë se prania në rritje e shfrytëzimit për punë të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore është evidente, do të ishte e rekomandueshme që të rishikohen treguesit përkatës dhe të përfshihen inspektorët e punës në zbatimin e tyre.

42. Lidhur me treguesit e viktimave e trafikimit për qëllime të kërkimit të lëmoshës, të përcaktuar në nenin 17, është vlerësuar se shumë nga fëmijët që kërkojnë lëmoshë në rrugë janë lypës të detyruar, pra, viktimat të trafikimit me qenie njerëzore. Prandaj, zbatimi i treguesve në këtë fushë duhet të monitorohet me kujdes.
43. Në lidhje me nenin 18, vlen të ceket se skllavëria shtëpiake në familje është një formë e trafikimit me qenie njerëzore e cila është jashtëzakonisht e vështirë për t'u zbuluar sepse shfrytëzimi i viktimave ndodh në banesa private. Si rezultat, treguesit për identifikimin e kësaj forme të trafikimit duhet të përcaktohen shumë qartë dhe të fokusohen në veçoritë e kësaj forme të trafikimit.
44. Lidhur me treguesit nga neni 19, viktimat e trafikimit me qëllim të heqjes së organeve shpesh rekrutohen nga grupe të ndjeshme, për shembull, ata që jetojnë në varfëri ekstreme. Çështjet e dhënies së pëlqimit dhe shfrytëzimit që lidhen me heqjen e organeve ndërlikohen nga fakti se shpesh viktimat pranojnë heqjen e organeve të tyre, madje mund të marrin edhe pagesën e rënë dakord për to. Prandaj, treguesit në këtë kategori të shfrytëzimit duhet të përshtaten me faktin se viktimat në këtë lloj shfrytëzimi shpesh janë të vetëdijshme se do të shfrytëzohen. Megjithatë, situata e ndjeshme në të cilën ndodhen, i bën të bën pre e shfrytëzimit.
45. Në anën tjetër, për sa u përket treguesve të veçantë të trafikimit me fëmijë, vlen të theksohet se si vajzat ashtu edhe djemtë janë të cënueshëm ndaj trafikimit të fëmijëve. Fëmijët mund të vihen në situata të rrezikshme dhe/ose të paligjshme, duke përfshirë skllavërinë, punën shtëpiake, shfrytëzimin seksual ose prostitucionin dhe tregtimin e drogës. Ata vuajnë dhunën, shfrytëzimin dhe abuzimin, duke përfunduar në punë të detyruar, martesë të detyruar, prostitucion, lëmoshë dhe rekrutim të armatosur. Për shkak të rrezikut të veçantë të hyrjes së fëmijëve në zinxhirin e trafikimit me qenie njerëzore dhe kërkesës së lartë për shërbimet e tyre, këta tregues duhet të zbatohen në mënyrë sa më efektive në mënyrë që sa më shumë fëmijë të mbrohen nga trafikimi me qenie njerëzore në Kosovë.
46. Në shtesë të raporteve dhe të dhënave statistikore, për qëllime të vlerësimit të rëndësisë dhe zbatueshmërisë së kësaj liste, siç është cekur më lartë, janë realizuar takime me institucionet relevante, ku ndër të tjera janë ngritur pyetje lidhur me zbatimin e saj në praktikë. Kësisoj:

46.1 Nga takimi me Policinë e Kosovës,² u konfirmua se punonjësit e policisë janë të njohur me përmbajtjen e Listës së Treguesve dhe se i zbatojnë ato gjatë identifikimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, por nuk është e mundur të vlerësohet se në çfarë mase ka ndikuar kjo listë në suksesin e identifikimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

46.2 Në takimin me Qendrën për Punë Sociale,³ u konkludua se punëtorët social, së bashku me Policinë dhe prokurorët e shtetit, zhvillojnë trajnime të rregullta në fushën e identifikimit të viktimave. Nga informacionet e marra në takim shihet se ka një problem të theksuar me specializimin e punonjësve social për rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, pasi që për çdo rast individual të trafikimit të qenieve njerëzore caktohet një punonjës social *ad hoc*, i cili është i disponueshëm në çdo kohë të caktuar.

46.3 Në takimin me Zyrën e Mbrojtësit të Viktimave, u tha se Lista e Treguesve zbatohet nga Policia dhe se mbrojtësit e viktimave nuk kanë shumë informacion për përmbajtjen e tyre.⁴

46.4 Grupi punues ka mbajtur takim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore,⁵ në të cilin janë trajtuar metodat dhe periudhat kohore të përgatitjes së raporteve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë dhe ndarjen e obligimeve ndërmjet institucioneve kompetente në fushën e identifikimit të viktimave të trafikimit. Gjatë këtij takimi u konkludua se duhet të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Ministrisë së Drejtësisë.

46.5 Është realizuar edhe takimi me Ministrinë e Shëndetësisë,⁶ ku u prezantua Lista e Treguesve për Identifikimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore të destinuar për të punësuarit në sektorin e shëndetësisë.

47. Për fund, siç u theksua edhe në pjesën e “rëndësisë” disa nga institucionet zbatuese, si Zyra e Mbrojtësit të Viktimave, nuk janë mjaftueshëm të njohur me përmbajtjen e treguesve të identifikimit të viktimave të trafikimit, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e zbatimit të tyre në praktikë. Njëherit, ekziston një mungesë e bashkëpunimit në nivel të duhur ndërmjet akterëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore.

² Takimet me Policinë e Kosovës, Drejtorinë për Trafikim me Njerëz, të mbajtura më 20 prill 2023 dhe më 23 maj 2023;

³ Takimi me Qendrën për Punë Sociale, i mbajtur më 23 maj 2023;

⁴ Takimi me Zyrën e Mbrojtësit të Viktimave i mbajtur më 20 Prill 2023;

⁵ Takimi me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore i mbajtur më 20 prill 2023;

⁶ Takimi me Ministrinë e Shëndetësisë, i mbajtur më 23 maj 2023.

IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Pas analizimit të Listës së Treguesve për Identifikimin Zyrtar të Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, në dritën e legjislacionit tjetër në fuqi në Kosovë, si dhe raporteve të organizatave ndërkombëtare, u arritën përfundimet, si në vijim:

IV.1. Përfundime për zbatimin

48. Statistikat zyrtare për numrin e viktimave të identifikuar në Republikën e Kosovës nga viti 2015 deri në vitin 2022, tregojnë se nga miratimi i kësaj Liste të Treguesve në vitin 2017, numri i viktimave të identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore nuk është rritur, përkundrazi gjatë disa viteve ka pasur rënie, në krahasim me numrin e viktimave të identifikuar para miratimit të listës në fjalë. Gjithsesi, sipas disa raporteve ndërkombëtare (raporti GRETA dhe TIP) Republika e Kosovës ende përballet me një rrezik real të rritjes së trafikimit të fëmijëve, veçanërisht për qëllimin e kërkim lëmshës së detyruar.
49. Siç u cek më lartë, identifikimi zyrtar i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore kryhet nga njësitë e Policisë, Prokuroria, Mbrojtësi i Viktimave dhe Qendrat për Punë Sociale, dhe për këtë arsye, institucionet e lartpërmendura janë edhe përgjegjëse për zbatimin e kësaj Liste të Treguesve.
50. Është konsideruar tejet e rëndësishme të vlerësohet edhe niveli i njohurive të organeve përgjegjëse për përmbajtjen e listës së treguesve. Nga takimet e zhvilluara me organet përgjegjëse për zbatimin e këtyre treguesve, ka rezultuar se ka një mospërputhje të theksuar ndërmjet nivelit të njohurive të tyre për përmbajtjen e Listës përkatëse të Treguesve. Konkretisht:
 - 50.1 Rezulton se punonjësit e Policisë së Kosovës, Drejtorisë për Trafikim me Qenie Njerëzore, si organi më i rëndësishëm në procesin e identifikimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, janë të informuar mirë dhe në mënyrë adekuate me përmbajtjen e Listës së Treguesve dhe kanë punëtori të rregullta dhe trajnime për zbatimin e tyre;
 - 50.2 Me këtë listë të treguesve janë të njohur edhe punonjësit e Qendrave për Punë Sociale, megjithatë, problemi kryesor i Qendrave për Punë Sociale në zbatimin e këtyre treguesve është se sistemi i mirëqenies sociale nuk ka punonjës social të specializuar për rastet e trafikimit me qenie njerëzore, pasi aktualisht punonjësit social janë caktuar në rastet e trafikimit me qenie njerëzore pavarësisht nga njohuritë dhe specializimi i tyre për fushën. Pra, është e mundur që një punonjës social me

përvojë dhe njohuri të pamjaftueshme për fenomenin e trafikimit me qenie njerëzore, të caktohet në një rast specifik të trafikimit.

50.3 Punonjësit e Zyrës së Mbrojtësit të Viktimave, ndonëse ofrojnë ndihmë ligjore për viktimat e identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore, nuk kanë njohuri të mjaftueshme për këtë listë treguesish dhe zbatimin e saj në praktikë.

50.4 Duke u bazuar në raportin vjetor të TIP të përmendur më parë (Raporti Vjetor i Trafikimit me Qenie Njerëzore i lëshuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan) rezulton se institucionet e Republikës së Kosovës duhet të ndërmarrin përpjekje të mëtejme për të identifikuar në mënyrë efektive fëmijët që shfrytëzohen për qëllime të kërkim-lëmshës së detyruar. Kështu që është e qartë se zbatimi në këtë fushë duhet të monitorohet me kujdes. Po ashtu, meqë këto viktima të trafikimit me qenie njerëzore janë të mitur dhe janë përdorur për qëllime të kërkim lëmshës së detyruar, është e domosdoshme që punonjësit socialë, fushëveprimi i të cilëve përfshin mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve, të informohen për përmbajtjen e këtyre treguesve.

50.5 Për rrjedhojë, pa punonjës social të specializuar për rastet e trafikimit me qenie njerëzore, ekziston rreziku i madh që punonjësit social të cilët nuk kanë përvojë apo njohuri të mjaftueshme profesionale për identifikimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, të marrin pjesë në procesin e identifikimit të viktimave.

51. Në shtesë të njohurive të duhura të treguesve, për zbatimin e suksesshëm të dokumenteve individuale në fushën kundër trafikimit, siç është lista, është I domosdoshëm edhe bashkëpunimi i ndërsjellë i autoriteteve të angazhuara në zbatimin e listës. Kjo nënkupton bashkëpunimin e tyre me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër trafikimit me qenie njerëzore, si organ qendror koordinues në fushën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Mirëpo, nga ky vlerësim rezulton se nuk është vendosur bashkëpunimi i duhur mes akterëve të përfshirë në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz.

IV.2. Përfundime për rëndësinë

52. Lista e Treguesve është një nga mjetet në dispozicion të zbatuesve (njësitë e Policisë, Prokuroria, Mbrojtësi i Viktimave dhe Qendra për Punë Sociale) për identifikimin e suksesshëm dhe efektiv të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

53. Pra, lista e treguesve është mjet praktik që mund të lehtësojë identifikimin e viktimave të trafikimit nga autoritetet përgjegjëse. Megjithatë, duhet pasur parasysh se treguesit nuk janë mjetet e vetme që garantojnë identifikimin e suksesshëm të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Për identifikimin e viktimave janë të rëndësishme edhe mjete të tjera, siç janë hetimet e ndryshme kriminale policore që ndërmerren kur

ekziston dyshimi se një person i caktuar po përgatit ose ka kryer veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore.

54. Prandaj, prania ose mungesa e këtyre treguesve nuk vërteton apo konfirmon ekzistencën e trafikimit me qenie njerëzore. Andaj, zbatuesit duhet t'i përdorin me kujdes dhe të kenë parasysh se ky është vetëm hapi i parë përpara një identifikimi të plotë të viktimave të trafikimit.
55. Rrjedhimisht, treguesit në fjalë kufizohen vetëm në një segment të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, d.m.th., identifikimi i viktimës. Por, duhet pasur parasysh se nuk ofrojnë një pamje të përgjithshme të cilësisë së sistemit për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore në një vend të caktuar.
56. Për fund, lista e treguesve që përbën objekt të këtij vlerësimi *ex-post* është sistemuar saktë dhe e përpunuar metodologjikisht. Treguesit bazohen në elementet e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore të specifikuar dhe përshkruara në Ligjin Nr. 04/L-218, Viktimat e Trafikimit dhe në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndahen në veprime, mjete dhe qëllime të shfrytëzimit. Në këtë mënyrë, duke përcaktuar treguesit në bazë të elementeve të përshkrimit dhe përcaktimit të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore, janë plotësuar parakushtet që asnjë nga segmentet apo fazat e trafikimit në të cilat gjenden viktimat, qofshin ato veprimi, mjete ose qëllimi i shfrytëzimit, mbetet jashtë shtrirjes së treguesve.

IV.3. Përfundime për harmonizimin

57. Siç u theksua më lartë, përveç në Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2017, një listë tjetër e treguesve është përcaktuar me Udhëzimin 01/2014. Për dallim, treguesit sipas Udhëzimit Administrativ 10/2017, bazohen në elementet e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore të specifikuar në Ligjin Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe Kodit Penal. Të njëjtat janë të ndarë në veprime, mjete dhe qëllime të trafikimit. Ndërsa, treguesit sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2014 për objektin e punës së Shërbimit Konsullor, Policisë Kufitare dhe Inspektoriatit të Punës, me një pjesë të treguesve të bazuar edhe në format e shfrytëzimit (seksuale, punëtore, skllavëria shtëpiake).
58. Pikërisht për faktin se të gjitha organet zbatuese të treguesve sipas Udhëzimit Administrativ QRK-Nr. 10/2017 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2014 janë përgjegjës për të njëjtin aktivitet, rekomandohet që të dyja Listat e Treguesve të përfshihen në një dokument të vetëm, për të lejuar bashkëpunimin dhe koordinimin e ndërsjellë, të të gjitha organeve në Republikën e Kosovës të ngarkuara me identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

REKOMANDIME

Duke u bazuar në të gjeturat e lartshënuara, ky raport i vlerësimit *ex-post* ofron rekomandimet, si në vijim:

59. Rekomandime mbi zbatimin

- 59.1 Të organizohen trajnime të vazhdueshme mbi përmbajtjen dhe zbatimin në praktikë të Listës së Treguesve për Identifikimin Formal të Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, për Mbrojtësit e Viktimave për shkak të njohurive të pamjaftueshme për Listën e Treguesve nga zbatuesit;
- 59.2 Të vazhdohet me mbajtjen e punëtorive dhe trajnimeve për zyrtarët policorë dhe prokurorët e shtetit për zbatimin e Listës së Treguesve në praktikë;
- 59.3 Të emërohen punonjës social të specializuar për rastet e trafikimit me qenie njerëzore dhe identifikimin e këtyre treguesve, pasi që aktualisht punonjësit socialë caktohen në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore pavarësisht njohurive dhe specializimit të tyre mbi trafikimin me qenie njerëzore;
- 59.4 Të përfshihen inspektorët e punës në trajnime të përbashkëta me institucionet e tjera zbatuese (Policia, Prokuroria, Mbrojtësit e Viktimave dhe Qendrat për Punë Sociale) për zbatimin praktik të Listës së Treguesve për shkak të rritjes së numrit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore që shfrytëzohen për punë, në nivel global dhe rajonal;
- 59.5 Të përgatiten raporte vjetore nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore mbi statistikën e viktimave të identifikuar sipas elementeve mbi të cilët bazohen treguesit (*Veprimet, Mjetet dhe Qëllimi i Shfrytëzimit*);
- 59.6 Të rishikohen treguesit për trafikimin e personave që shfrytëzohen për lëmshë për shkak se është vlerësuar se ka prani të konsiderueshme të kësaj forme të shfrytëzimit në Kosovë;
- 59.7 Të përfshihen grupe të reja të treguesve, si treguesit për mosdhënien e pagave dhe tregues të trafikimit pas fazës së shfrytëzimit, të cilët mbulohen ose përsëriten nga tregues të tjerë;
- 59.8 Të realizohet një koordinim më i mirë i aktiviteteve ndërmjet institucioneve zbatuese dhe Zyrës e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, gjatë aplikimit të treguesve dhe të përmirësohet komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet zbatuesve.

59.9 Të përgatiten në mënyrë të vazhdueshme, raporte të tilla statistikore, të cilat do t'a bënin më të drejtpërdrejtë vlerësimin e këtyre treguesve. Kjo sepse, raportet e ndërmjetme mbi zbatimin e Listës së Treguesve, që së paku mund të ofrojnë të dhëna statistikore për numrin e viktimave të identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore për secilin grup treguesish nuk janë të disponueshme.

60. Rekomandime mbi rëndësinë

60.1 Të rishikohen treguesit që kanë të bëjnë me fushën e shfrytëzimit të fëmijëve në përgjithësi dhe shfrytëzimin e fëmijëve me qëllim të kërkim lëmoshës së detyruar në veçanti;

60.2 Të plotësohet lista e treguesve me një grupi të ri treguesish që fokusohen në trendet më të reja të trafikimit me qenie njerëzore, si rekrutimi dhe shfrytëzimi online i viktimave të trafikimit;

60.3 Të shtohen grupe të reja të treguesve që synojnë identifikimin e viktimave të trafikimit në mesin e emigrantëve të paligjshëm dhe azilkërkuesve;

60.4 Meqë trafikimi me qenie njerëzore është një fushë shumë dinamike, rekomandohet që treguesit të përputhen me dinamikat më të fundit në këtë fushë.

60.5 Të evitohet përsëritja e disa treguesve, si treguesit e mbajtjes së pagave në burim dhe treguesit e trafikimit pas fazës së shfrytëzimit, të cilët mbulohen ose mbivendosen me disa tregues të tjerë, si treguesit e shfrytëzimit të punës. Andaj nuk është e nevojshme për këto apo tregues të ngjashëm të renditen më shumë se një herë.

61. Rekomandime mbi harmonizimin

Të harmonizohet/bashkohet Lista e Treguesve nga Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2014 për Identifikimin e Hershëm të Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore nga Shërbimet Konsullore, Policia Kufitare dhe Inspektorati i Punës, me Listën e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 10/2017 për Identifikimin Formal të Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, në mënyrë që të gjitha listat e treguesve si dhe zbatuesit e tyre, të përfshihen në një dokument të vetëm.